

Kujtesë mbi zbatimin e Lgjit “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2011, ushtroi kontroll në disa njësi ekonomike lidhur me mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare. Nga kontrolli rezultoi se shumë njësi ekonomike nuk zbatojnë korrektësisht Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Mos zbatimi korrekt i ligjit të mësipërm nga njësitë ekonomike, përveç të tjerash, vjen edhe nga mosnjohja e tij. Meqenëse jemi në periudhën e përgatitjes së Pasqyrave Financiare për vitin ushtrimor 2011, shohim me vend që të bëjmë një kujtesë të ligjit të mësipërm.

✚ Përgatitja e Pasqyrave Financiare do të bëhet sipas **Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit** nga këto njësi ekonomike:

a) nga shoqëritë e listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë dhe filialet e tyre, subjekt i konsolidimit të llogarive;

b) nga bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare, të ngjashme me bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe të risigurimeve, fondet e letrave me vlerë dhe të gjitha shoqëritë e licencuara për të kryer veprimtari investimi në letrat me vlerë, edhe kur ato nuk janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë;

c) nga njësi ekonomike të tjera të mëdha, të palistuar në një bursë zyrtare letrash me vlerë, kur ato tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për të ardhurat vjetore dhe numrin e të punësuarve me VKM 742, datë 07.11.2007, pika 2, ku shprehimisht thuhet:

Njësitë e tjera ekonomike, të cilat nuk janë objekt i ligjit të sipërpërmendur, do të jenë subjekt i zbatimit të SNK, kur tejkalojnë njëkohësisht, për dy vitet e fundit, këto kufij:

- 1) Të ardhurat vjetore në shumën 1.250.000.000 lekë;
- 2) Numri mesatar i të punësuarve, mbi 100 punonjës në vit

✚ Të gjitha njësitë e tjera ekonomike duhet të zbatojnë **Standardet Kombëtare të Kontabilitetit**. Ky grup njësisht ndahet në njësitë ekonomike që do të zbatojnë standardet SKK 1 deri në SKK 14 dhe grupin e Mikronjësive që hartojnë Pasqyra Financiare sipas SKK 15.

Këto të fundit janë njësitë ekonomike ku punësohen më pak se 10 persona dhe kanë një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë. Këto kritere duhet të plotësohen për dy vitet e fundit.

✚ Përsa i përket mikronjësive me status person fizik dhe që realizojnë xhiro vjetore deri në 2 milion lek, ato do të mbajnë kontabilitetin e thjeshtuar me regjistrim të njëfishtë në bazë monetare. Këto njësi nuk kanë detyrimin të hartojnë pasqyra financiare.